

VENDIM
Nr. 139, datë 20.3.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 867, DATË 10.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun II, të vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet kësaj procedure, kanë të drejtë:

a) të kërkojnë nga institucionet e tjera të administratës shtetërore që t’u sigurohen të dhëna, informacione apo çdo lloj ndihme tjetër, të cilat janë të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale të tyre;

b) të krijojnë rrjete profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve për fusha të caktuara, të cilat kontribuojnë në rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe komunikimit, me synimin e:

i. shkëmbimit të eksperiencave më të mira, njohurive dhe praktikave për procese pune të ngjashme;

ii. shkëmbimit/krahasimit të informacionit apo të të dhënave në fushën përkatëse;

iii. diskutimit të çështjeve apo problematikave;

iv. adresimit të kërkesave pranë institucioneve përgjegjëse për të bërë rregullime të posaçme nëpërmjet akteve rregullatore që mbulojnë fushën përkatëse.”.

2. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Bashkëpunimi, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, mund të shfaqet në një nga format e mëposhtme:”.

3. Pas pikës 22, shtohen pikat 23, 24 e 25, me këtë përmbajtje:

“23. Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, krijohen për të trajtuar çështje, të cilat lidhen me qëllimin e ekzistencës dhe/ose fushën e përgjegjësisë së institucionit që i krijon. Në to marrin pjesë nëpunës/punonjës të institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë të punësuar në njësitë organizative të ngarkuara me ekzekutimin e detyrave që lidhen me fushën për të cilën krijohet rrjeti dhe kanë njohuri e aftësi më të mira në këtë fushë.

24. Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve ngrihen me urdhër të Kryeministrit, ministrit përkatës apo titullarit të institucionit, që ka në fushë përgjegjësie fushën për të cilën ngrihet rrjeti. Në urdhrin e ngritjes së rrjetit përcaktohen qëllimi, synimet e përfitimet, struktura udhëheqëse, struktura të tjera në përbërje të tij, nëse është rasti, anëtarët, detyrat e përgjegjësitë, mënyra e organizimit e funksionimit të tij dhe numri maksimal i anëtarëve. Si rregull, në përbërje të rrjetit nuk mund të ketë më shumë se 30 (tridhjetë) anëtarë.

25. Si rregull, struktura udhëheqëse e rrjetit profesional ndërinstitucional të nëpunësve është institucioni/njësia organizative, që ka kompetencat më të larta sa i takon fushës në të cilën ngrihet rrjeti.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Erion Braçe